

R E L A C I O N

PËR

AKTIN NORMATIV “PËR DISA SHTESA NË LIGJIN NR.9632, DATË 30.10.2006, “PËR SISTEMIN E TAKSAVE VENDORE”, TË NDRYSHUAR”

I. QËLLIMI I PROJEKTAKTIT DHE OBJEKTIVAT QË SYNOHEN TË ARRIHEN

Kjo nismë ligjore është ndërmarrë duke mbajtur në konsideratë situatën emergjente të krijuar nga dëmtimet që ka shkaktuar tërmeti i fuqishëm i datës 21 shtator 2019, në disa qytete të vendit, kohën e pamjaftueshme për rregullimet ligjore sipas procesit legjislativ, nevojën e menjëhershme për ndërtimin e riparimin e ndërtesave të dëmtuara.

Gjithashtu, akti normativ parashikohet të përjashtojë nga taksa e ndikimit në infrastrukturë investimet, të destinuara për qëllime banimi, të cilat kanë si qëllim ndërtimin, riparimin apo restaurimin e ndërtesave të dëmtuara si pasojë e fatkeqësive natyrore, që mund të ndodhin në të ardhmen.

II. VLERËSIMI I PROJEKTAKTIT NË RAPORT ME PROGRAMIN POLITIK TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE, ME PROGRAMIN ANALITIK TË AKTEVE DHE DOKUMENTE TË TJERA POLITIKE

Akti normativ nuk është i parashikuar në programin e përgjithshëm analitik të projektakteve, për vitin 2019, për miratim nga Këshilli i Ministrave.

III. ARGUMENTIMI I PROJEKTAKTIT LIDHUR ME PËRPARËSITË, PROBLEMATIKAT, EFEKTET E PRITSHME

Akti normativ parashikon përjashtimin nga taksa e ndikimit në infrastrukturë të të gjitha investimeve për rindërtimin, riparimin apo restaurimin e ndërtesave, për qëllime banimi, të dëmtuara si pasojë e fatkeqësive natyrore, sipas përkufizimit të legjislacionit në fuqi për mbrojtjen civile. Njëkohësisht, parashikohet edhe një dispozitë transitorë, e cila përjashton nga detyrimi për të paguar këtë taksë personat që aplikojnë për t’u pajisur me leje rindërtimi, riparimi, restaurimi për qëllime banimi, si pasojë e tërmetit të fuqishëm të datës 21 shtator 2019, dhe synon të zbusë efektin e dëmeve financiare të shkaktuara nga fatkeqësitë natyrore, që sjellin dëmtime të pasurisë së tyre të paluajtshme.

IV. VLERËSIMI I LIGJSHMËRISË, KUSHTETUTSHMËRISË DHE HARMONIZIMI ME LEGJISLACIONIN NË FUQI VENDAS E NDËRKOMBËTAR

Akti normativ është në harmoni me legjislacionin shqiptar në fuqi dhe mbështetet në nenin 101 të Kushtetutës.

V. VLERËSIMI I SHKALLËS SË PËRAFRIMIT ME ACQUIS COMMUNAUTAIRE (PËR PROJEKTAKTET NORMATIVE)

Ky akt normativ nuk synon përafrimin me ndonjë *acquis* të Bashkimit Evropian.

VI. PËRMBLEDHJE SHPJEGUESE E PËRMBAJTJES SË PROJEKTAKTIT

Akti normativ përbëhet nga 3 nene.

Në nenin 1 parashikohet që investimet për rindërtimin, riparimin apo restaurimin e ndërtesave të destinuara për qëllime banimi, të dëmtuara si pasojë e fatkeqësive natyrore, sipas legjislacionit në fuqi për mbrojtjen civile, do të përjashtohen nga pagesa e taksës së ndikimit në infrastrukturë.

Ky nen, në paragrafin e dytë, autorizon Këshillin e Ministrave që, me vendim, të përcaktojë kushtet, rregullat dhe dokumentet që shoqërojnë kërkesën për përjashtimin nga detyrimi për pagesën e taksës së ndikimit në infrastrukturë.

Në nenin 2, të projektaktit, parashikohet shtimi i një dispozite kalimtare në ligjin nr.9632, datë 30.10.2006, “Për sistemin e taksave vendore”, të ndryshuar, për përjashtimin nga taksa e ndikimit në infrastrukturë të të gjithë personave, që aplikojnë për t’u pajisur me leje për ndërtimin, riparimin apo restaurimin e ndërtesave të destinuara për qëllime banimi, si pasojë e tërmetit të fuqishëm të datës 21 shtator 2019.

Në nenin 3 parashikohet hyrja në fuqi e aktit normativ.

VII. INSTITUCIONET DHE ORGANET QË NGARKOHEN ME ZBATIMIN E PROJEKTAKTIT

Për zbatimin e këtij akti normativ ngarkohen Këshilli i Ministrave, Ministria e Financave dhe Ekonomisë dhe njësitë e vetëqeverisjes vendore.

VIII. MINISTRITË, INSTITUCIONET DHE PERSONAT QË KANË KONTRIBUAR NË HARTIMIN E PROJEKTAKTIT

Institucioni propozues i projektaktit normativ është Ministria e Financave dhe Ekonomisë.

IX. RAPORTI I VLERËSIMIT TË TË ARDHURAVE DHE SHPENZIMEVE BUXHETORE

Efektet e të ardhurave dhe të shpenzimeve nga zbatimi i aktit normativ do të përfshihen në programin e miratuar të buxhetit për institucionet qendrore e vendore.

KËSHILLI I MINISTRAVE